

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

Në çështjen juridike të :**AC-I-22-0112-A0001***Paditësi*

F S, Prizren

Kundër:*E paditura/Ankuesja***N.SH. “Farmakos”** (në likuidim), Prizren, me përfaqësuese **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. ”Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishte, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-13-0594, të datës 27 janar 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 18 janar 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1. Ankesa e të paditurës është e bazuar.
2. Ankesa ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ0266-0178 i datës 18 mars 2013 refuzohet si e pabazuar.
3. Vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ0266-0178 i datës 18 mars 2013.
4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 22 prill 2013, paditësi kishte paraqitur një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ0266-0178 të datës 18 mars 2013, me të cilin vendim kërkesa e paditësit për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 1,947.00 euro ishte pranuar nga ana e AL-së në shumën prej 563.20 euro, ndërsa pjesa e mbetur në shumën prej 1,383,80 euro ishte refuzuar si e pabazuar. Në llogaritjen e shumës së detyruar, AL kishte marrë parasysh pagën mujore në momentin e pushimit nga puna dhe numrin e viteve faktike të shërbimit me punë në N.SH. Paga mujore e kërkuesit në momentin e pushimit nga puna ashtu siç pasqyrohet në listën e pagave ishte 120.00 euro, ndërsa vitet e punës së kërkuesit janë llogaritur duke llogaritur periudhën e punësimit në N.SH nga data e rekrutimit në punë deri në muajin e fundit të shërbimit. Ndërsa, sa i përket shumës së refuzuar thekson se kjo shumë përbën shumë të pajustificueshme të kërkuar.

Në ankesën e paditësit theksohet se paga lineare prej 120.00 euro nuk mund të trajtohet si pagë e rregullt e kontraktuar por valide është sipas Aktvendimit të KP në lartësi prej 476.15 euro dhe kjo duhet të merret bazë për këtë lloj kompensimi. Ankuesi mendon se këtu është gabimi i AL-së pra kur ka marrë për bazë pagën lineare e jo atë mujore sipas kontratës së punës. I njëjti i propozon gjykatës që të aprovohet ankesa si e bazuar, ndërsa t'i kompensohen pagat e plota sipas Aktvendimit nr. 14/2 të datës 26 nëntor 2001 në lidhje me kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës e jo sipas akontacionit të përkohshëm linear prej 120.00 euro si dhe të kompensohen dallimet e të gjitha rrogave që janë dhënë si akontacion për 16 muaj (nga 1 nëntor 2002 deri më 9 mars 2004).

Ankesës i kishte bashkëngjitur këto prova: një Njoftim se është iniciuar procedura gjyqësore ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ026-0178 të datës 18 mars 2013, vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ026-0178 të datës 18 mars 2013, një Aktvendim të Këshillit të punëtorëve të marrë në mbledhjen e datës 26 nëntor 2001, një Aktvendim me nr. 01/0001, një vendim të IFK "Farmakos"-Prizren të datës 31 tetor 2002 si dhe listën e stazhit të punëtorëve që u takon dëmshpërblimi i njëkohshëm.

Me datë 10 tetor 2016, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtjen e saj në të cilën theksohet se parashtruesi nuk ka identifikuar se cili nen konkret i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga

Autoriteti i Likuidimit gjatë marrjes së vendimit dhe në këtë mënyrë ka shkelur nenin 70.2 të Ligjit 03/L-033 që parashikon se ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të Autoritetit të Likuidimit duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin për AKP. Nga leximi i nenit 40.1.6.2 të Shtojës së Ligjit nr. 04/L-034 rrjedh që ekzistojnë dy kushte ligjore për pranueshmëri për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës: kushti i pushimit nga puna i punëtorit që duhet të jetë pasojë e një veprimi të ndërmarrë nga AKP. Pala kundërshtare dëshiron të theksoj se dëmshpërblimi për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës është një e drejtë e cila synon kompensimin e humbjes financiare që pëson punëtori pasi që për shkak të privatizimit/likuidimit të N.SH-së nga AKP-ja atij nuk i paguhen me rroga nga N.SH-ja. Sa i përket pretendimit të parashtruesit se AL duhet të kishte konsideruar pagën mujore të përcaktuar në kontratën e tij të punës, pala kundërshtare konsideron se është jo e logjikshme të bëhet kompensimi i humbjes financiare duke u bazuar në pagën që parashtruesi pretendon se e merrte tre vite para privatizimit të N.SH-së. Nga viti 2002 e në vazhdim parashtruesi ka realizuar si pagë mujore shumën prej 120.00 euro, të cilën shumë AL ia kishte pranuar në lartësinë e 5 pagave si pasojë e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, andaj pretendimi i parashtruesit për përlllogaritjen e një vlere më të lartë se 120.00 euro të pagës mujore, rezulton si e pabazuar. Andaj, e paditura i kishte propozuar gjykatës që të refuzohet ankesa e paditësit si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi i AL-së. Mbrojtjes i kishte bashkëngjitur emërimin e Autoritetit të Likuidimit dhe listë pagesat e N.SH “Farmakos” për janar dhe shkurt 2004.

Me datë 27 janar 2022, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-13-0594 kishte refuzuar ankesën e paditësit si të pabazuar, ndërsa, kishte ndryshuar pikën 1 të Aktvendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ026-0178 të datës 18 mars 2013, ashtu që në vend të shumës 563.20 euro, ankuesit i kishte pranuar të drejtën në dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 840.00 euro. Gjithashtu kishte ndryshuar pikën 2 të Aktvendimit të Autoritetit të Likuidimit, ashtu që në vend të shumës 1,383.80 euro duhet të jetë shuma prej 1,107.00 euro refuzohet. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi theksohet se pretendimet ankimore të ankuesit se i takon e drejta në dëmshpërblim në shumën prej 1,940.00 euro është i pabazuar. vendimi i Këshillit të Punëtorëve (KP) i parashtruar nga ana e ankuesit dhe lista e pagave e parashtruar nga ana e AKP-së tregon se ankuesi ka pasur pagën mujore në

shumën prej 120.00 euro. Lista e pagave për më tepër tregon se ankuesi në momentin e privatizimit të N.SH-së kishte pagën e cekur si më lartë. Andaj, pavarësisht pohimeve të ankuesit dhe kërkesës së tij si dhe vendimit të parashtruar, por edhe një regjistri gjykata konsideron se vendimi i KP dhe lista e pagave dëshmojnë të kundërtën e pohimeve të ankuesit. Kjo posaçërisht për faktin se Këshilli i punëtorëve konsiderohej si organi më i lartë vetëqeverisës i N.SH-së e në raport me këtë edhe gjitha vendimet që nxirren nga ky këshill. Pra nuk është kontestuese nga asnjëra palë se ankuesi ka punuar pranë N.SH-së dhe se në momentin e privatizimit të saj kur edhe i është ndërprerë marrëdhënia e punës. Ankuesi ka pasur gjithsej 34 vite përvojë pune. Sipas nenit 76 paragrafi 7, nën-paragrafi 7.5 të Ligjit për Punën, për 34 vite përvojë pune, ankuesit në kuptim të kompensimit i takojnë 7 paga mujore. Kjo për faktin se përvoja e punës së ankuesit bie në kategorinë e përcaktuar. Andaj kur kësaj përvoje i llogariten 7 paga mujore dhe e shumëzojmë me 120.00 euro, ankuesit i bie t'i takoj shuma prej 840.00 euro. Pika 2 e vendimit të AL-së ishte ndryshuar ngase nga shuma e përgjithshme është zbritur shuma e pranuar dhe mbetja i bie të jetë si në pikën 3 të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

Me datë 25 shkurt 2022, AKP-ja kishte paraqitur ankesë kundër Aktgjykimit C-IV-13-0594 të datës 27 janar 2022, në të cilën i kishte propozuar Kolegjit të Apelit që të ndryshoj Aktgjykimin e ankimuar duke refuzuar ankesën e paditësit ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit dhe duke vërtetuar këtë të fundit, në atë mënyrë që shuma që ishte refuzuar dhe ajo që ishte pranuar të mbetet e pandryshuar dhe e përlllogaritur ashtu si në vendimin e AL-së. Në ankesë theksohet se në llogaritjen e shumës së detyruar, AL kishte marrë parasysh pagën mujore në momentin e pushimit nga puna dhe numrin e viteve faktike të shërbimit me punë në N.SH. Paga mujore e kërkuesit për muajt e fundit para privatizimit ishte 120.00 euro. Vitet e punës së kërkuesit janë llogaritur duke llogaritur periudhën e punësimit në N.SH nga data e rekrutimit në punë deri në muajin e fundit të shërbimit. Duke aplikuar metodën e llogaritjes sipas ligjit të aplikueshëm, periudha e punësimit është 34 vite e barasvlershme me 5 paga mujore. Pra këtu bëhet fjalë për 5 paga të papaguara me vlerë prej 120.00 euro. Andaj, Autoriteti i Likuidimit duke aprovuar shumën e përgjithshme prej 563.20 euro i refuzoi paditësit shumën prej 1,383.80 euro, duke theksuar se kjo shumë përbën shumën e pajustificueshme të kërkuar. Andaj, duke u bazuar në këto që u thanë, i kishte propozuar Kolegjit të Apelit si më lartë. Ankesës i kishte bashkëngjitur Aktgjykimin e ankimuar,

vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, një parashtrësë të AKP-së të datës 16 shkurt 2022.

Paditësi me datë 6 tetor 2023 e kishte pranuar ankesën e të paditurës, mirëpo nuk kishte paraqitur përgjigje.

Arsvetimi i ligjor

Ankesa e të paditurës është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar shkallës së parë të DHPGJS-së duhet të priset, Padia e paditësit të refuzohet si e pa bazuar ndërsa Vendimi i Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ026-0178 të datës 18 mars 2013 duhet të vërtetohet .

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit për kompensim për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës në shumën prej 1,947.00 euro ishte pranuar nga Autoriteti i likuidimit në shumën prej 563.20 euro, duke i llogaritur 5 paga në shumën prej 120.00 euro, shumë kjo e marrë nga paga që kishte paditësi si pagë mujore deri në momentin e privatizimit të N.SH-së. Ndërsa kishte refuzuar si të pabazuar shumën prej 1,383.80 euro.

Paditësi në ankesën e tij në shkallë të parë të ushtruar kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ023-0178 të datës 18 mars 2013, përveç që vazhdon të kërkoj kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, i njëjti i kishte bashkëngjitur edhe këto prova të shkresa të lëndës: një Njoftim se është iniciuar procedura gjyqësore ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ026-0178 të datës 18 mars 2013, Vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ026-0178 të datës 18 mars 2013, një Aktvendim të Këshillit të punëtorëve të marrë në mbledhjen e datës 26 nëntor 2001, një Aktvendim me nr. 01/0001, një vendim të IFK “Farmakos”-Prizren të datës 31 tetor 2002 si dhe listën e stazhit të punëtorëve që u takon dëmshpërblimi i njëkohshëm.

Ndërsa, e paditura në mbrojtjen e saj kishte bashkëngjitur listë pagesat e N.SH “Farmakos” për janar dhe shkurt 2004.

Shkalla e parë e DHPGJS, pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, kishte nxjerrë Aktgjykim me të cilin i kishte njohur paditësit të drejtën në kompensim në emër të dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 840.00 euro, me arsyetimin se i njëjti kishte dorëzuar prova relevante që dëshmonin se N.SH në fjalë ka detyrim ndaj paditësit, ndërsa kishte refuzuar pjesën e mbetur të shumën prej 1,383.80 euro e cila nuk ishte e mbështetur në prova materiale.

Kolegji i Apelit në rastin konkret vlerëson se shkalla e parë e DHPGJS nuk kishte vepruar drejtë me rastin e marrjes së këtij Aktgjykimi për shkak të zbatimit të gabuar të Ligjit material.

Në rastin konkret shkalla e parë e DHPGJS-së ishte bazuar në Ligjin për Punën nr. 03/1-212 i cili Ligj ishte publikuar më 18 nëntor 2010.

Sipas shkresave në lëndë dhe thënieve të palëve ndërprerja e marrëdhënies së punës kishte ndodhur më 10 mars 2004 në kohën kur NSH-ja ishte privatizuar. Në këtë kohë ligj i zbatueshëm në Kosovë ishte rregullorja e UNMIK-ut nr, 2001/17.

Sipas nenit 12 paragrafi, dh, (V) të Rregullores 2001/17, punëtori me më shumë se 30 vite punë ka të drejtë në kompozimin e 05 pagave për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës sipas fuqisë së Ligjit . Rasti në fjalë është i tillë.

Paditësi kishte 34 vite përvojë pune dhe marrëdhënia e punës i ishte ndërprerë si rezultat i privatizimit të N.SH-së më 10 mars 2004 të dyja këto fakte të cilat as paditësi nuk i konteston apo kundërshton, do të thotë se si të tilla janë të vërtetuara.

Kolegji i Apelit vlerëson se në bazë të viteve të përvojës së punës që paditësi kishte ofruar shërbime në N.SH (34 vite përvojë pune), të njëjtit ashtu siç e thekson edhe Autoriteti i Likuidimit i takojnë 05 paga mujore në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës.

Prandaj, duke u bazuar në këto që u thanë më lart, Kolegji i Apelit konsideron se Autoriteti i Likuidimit ka vepruar drejtë kur paditësit i ka njohur të drejtën në kompensim për shkak të

ndërprerjes së marrëdhënies së punës në shumën prej 563.20 euro, sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Nga arsyet e cekura më lartë, ankesa e të paditurës aprovohet si e bazuar, refuzohet padia e paditësit dhe vërtetohet Vendimi i Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ026-0178 të datës 18 mars 2013.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 18 janar 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues
